

STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ‘DR SOLAR’ SHPK

Sot me datë 08 JANAR 2024 (dymijëenjëzetekater) , ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **DR SOLAR SHPK**

Themeluesit e shoqërisë janë:

a) **Dritan Babasuli**, i biri i Kujtim, shtetas Shqipetar, lindur me 17/03/1980 në Pogradec dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. Mine Peza; ND. 17 H.7; AP.11; Njësia Administrative nr 9. Identifikuar me LeternjoftimID meNr. 033532101 dhe Nr Personal I00317177J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në cilësinë e Ortakut të shoqërisë).

b) **Roland Kokonozi**, i biri i Xhevdet, shtetas Shqipetar, lindur me 20/02/1980 në Prrenjas, Librazhd dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. Shyqyri Brari; ND. 7 H.1; Farke, Selite. Identifikuar me LeternjoftimID meNr. 036509871 dhe Nr Personal I00220213G, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në cilësinë e Ortakut të shoqërisë).

Te cilet kane themeluar shoqërinë ‘**DR SOLAR’ SHPK** dhe kane vendosur të nënshkruajnë statutin e shoqërisë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërise, në Kodin Civil, në Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; i ndryshuar dhe në ligjin Nr. 9723, dt 03.05.2007 ‘Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit’ (i ndryshuar) si dhe dispozitat e tjera te legjistacionit Shqipëtare në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare , si vijon:

Kreu I Emri, Forma, Objekti i veprimtarisë, Kohëzgjatja, Selia dhe Kapitali Themeltar

Neni 1: Emri i Shoqërise

Emri i shoqërisë, në përputhje me kriteret ligjore të Republikës së Shqipërisë, është
‘DR SOLAR’ SHPK

Neni 2: Forma Ligjore

Shoqëria ‘**DR SOLAR’ SHPK** (Këtu e në vijim referuar si **Shoqëria**) është themeluar dhe organizuar si shoqëri me pernjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky statut dhe ligji nr 9901 , date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; i ndryshuar Shoqëria do te operoj ne perputhje te plote me fuqi te Republikës së Shqipërisë.



Neni 3: Objekti i veprimitarisë

Mbeshtetur ne nenit 7 te ligjit 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; i ndryshuar Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike. Financimi, projektimi, zhvillim, ndërtim, i hidrocentraleve dhe impianteve të tjera për prodhimin e energjisë elektrike, shpërndarjes, transmetimit të energjisë elektrike, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja, shfrytëzimi i tyre, prodhimi dhe tregtimi i energjisë elektrike. Ndërtim, projektim, konsulencë, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit. Import-eksport i te gjithë llojeve të materialeve dhe makinerive të ndërtimit dhe jo vetem. Ndërtim, permirësim, mirëmbajtje të rrugëve, mbikalimeve dhe nënkalimeve, urave, tuneleve, porteve, aeroporteve, digave dhe veprave të tjera të infrastrukturës. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimitari tjetër tregtare të lejueshme që është e nevojshme dhe e dobishme për të përbushur objektin e saj.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë per një periudhe kohore te papercaktuar.

Neni 5: Selia

Selia e shoqërisë ne perm bushje te aktivitetit te saj tregtar ndodhet ne adresën: **Qendra Tregetare Prrenjas katë i 1 zyra 7, Nr.Pasurie 659/35,ZK 2925, Prrenjas.**

Vendimi per transferimin e selise apo te krijoje qendra detysore eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise.

Neni 6: Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 (Dhjete mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a) Ortaku themelues Z.Dritan Babasuli, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 7 000 (Shtate mijë) Lekë, që përben 70 % të kapitalit themeltar të shoqërisë,
- b) Ortaku themelues Z. Roland Kokonozi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3 000 (Tre mijë) Lekë, që përben 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7: **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8: **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**


Neni 9: **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;



- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10: Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11: Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

The image shows two handwritten signatures in blue ink. The signature on the left consists of the letters 'B' and 'J'. The signature on the right is more complex and includes the letters 'B' and 'B'.

- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13:
Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 14:
Administrimi

Shoqeria Tregtare ‘DR SOLAR’ SHPK do te perfaqesojet ne marredhenie me te tretet nga Administratori i saj, i cili vepron ne cilesine e perfaqesuesit ligjor, ne perputhje me kete statut dhe ligjin per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.


Administrator i Shoqerise ‘DR SOLAR’ SHPK emerohet Z. **Dritan Babasuli**, i biri i Kujtim, shtetas Shqipetar, lindur me 17/03/1980 në Pogradec dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Mine Peza; ND. 17 H.7; AP.11; Njësia Administrative nr 9. Identifikuar me LetërnjoftimID me Nr.033532101 dhe Nr Personal I00317177J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 15:
Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



- dh) te kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) te raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me DRizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) te kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori mund te autorizoj pale te treta per kryerjne e veprimeve te ndryshme te tilla si: depozitimi I pasqyrave financiare ne Qendren Kombetare te Biznesit, perfaqesimin e shoqerise para institucioneve shteterore etj perpara organeve gjyqesore etj pervec rasteve te parashikuara si kompetence ekskluzive e Administratorit nga ky statut apo ligji.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Statuti ose rregulloret, të miratuara nga këshilli i administrit, mund të parashikojnë ndryshe

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojet administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 16: **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale osesolidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në imedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë DRizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të

vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Kreu III **Viti finansiar-Ekspertet**

Neni 17:

Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 18:

Ekspertet

Eksperti do te emerohet me vendim te Asamblese se Ortakeve, nese eshte e nevojshme ; Eksperti i autorizuar do te kryej detyren e tij ne perputhje me ligjet ne fuqi.

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu IV **Prishja –Riorganizimi i shoqërisë**

Neni 19:

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne edo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20:
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 21:
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.


Neni 22:
Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K E T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
'DR SOLAR' SHPK

DRITAN BABASULI

(Emer, Mbiemër, Nënshkrimi)



ROLAND KOKONOZI

(Emer, Mbiemër, Nënshkrimi)

